

P.nr.975/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtari i vetëm gjykues Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të të pandehurës K. A., për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, nga neni 414, të KPRK, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.8154/2013, të datës 30.04.2014, në shqyrtimin fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 26.04.2017, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i Shtetit Ajshe Ferati dhe e pandehura K. A., pas seancës, me datë 26.04.2017, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura K. A., e bija e R. dhe L., e vajzërisë M., e lindur me *data e lindjes...*, në P., tani me vendbanim në P., rr. "...", pa numër, (afër M. E.), me numër personal *numri personal...*, e shkurorëzuar- nënë e një fëmije, ka te kryer shkollën fillore, e pa punë- shfrytëzuese e ndihmës sociale, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

S e p s e: prej datës 07.11.2013, gjatë kontrollit të bërë nga zyrtarët e KEDS, është konstatuar se e pandehura, me qëllim që vetes t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, në njëhisorin elektrik nr. 9167833, i vendosur në shtëpinë e saj, ka këputur bllobbën distributive nr. K000102569, dhe është ri kyçur në rrjetin elektrik pa autorizim të KEDS, edhe pse më parë ka qenë e shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, nga neni 414, të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 41; 45; 49; 51; 52 dhe 414, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM ME KUSHT

- Në kohëzgjatje prej **dy (2) muaj burgim**, i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, në qoftë se e pandehura **K. A.**, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.
- E pandehura lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, për shkak të gjendjes së saj ekonomike.
- E dëmtuara – KEDS me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të saj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të KEDS, nr. CMS-K/DPR-805, të datës 29.11.2013, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.8154/2013, të datës 30.04.2014, ka akuzuar të pandehurën K. A., për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, nga neni 414, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 26.04.2016, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, e akuzuara K. A., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar fajtores për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe ka shtuar se e ka pasur gjendjen e vështirë ekonomike, përkatësisht nuk ka pasur mundësi ta paguaj rrymën dhe KEDS e ka shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit, duke shtuar se rryma për të ka qenë shumë e nevojshme, duke pasur parasysh se atëherë fëmija i saj ka qenë tetë vjeç, ka pasur frikë për shkak të errësirës dhe është ri kyçur në rrjetin elektrik. Po ashtu, e pandehura ka thënë se është shfrytëzuese e ndihmës sociale dhe më vështirësi e kalon jetën e përditshme, duke pasur parasysh se për ekzistencën e saj dhe të djalit të saj ajo merr 73 euro në muaj, nga të cilat, ka thënë se është e vështirë të paguajnë gjërat e nevojshme për ekzistencë dhe faturat mujore për shërbimet e ofruara. Në fund të fjalës së saj, e pandehura ka propozuar që asaj t'ia shqiptoi një dënim sa më të butë.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga e pandehura, Prokurori i shtetit ka deklaruar, se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga e pandehura, pasi që ky pranim u bë në mënyrë vullnetare, pa presion, duke i kuptuar pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, dhe në fund të fjalës së tij Prokurori i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ta merr si rrethanë lehtësuese me matjen e dënimit.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës, ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, pasi që ky pranim është bërë me vullnetin e saj të lirë dhe konform dispozitave të nenit 248, të KPPK.

Pas deklarimit të pandehurës se ndihet fajtores për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjyqtari me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura, pasi është bindur se ajo e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht, dhe duke u mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtores të akuzuarën, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjëse.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarës gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; pranimin e fajit për veprat e kryera penale; rrethanat personale të kryeses dhe sjelljen e saj pas kryerjes së veprave penale, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarës i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtores, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe se me dënimin e shqiptuar kundër saj, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK.

Në rastin konkret, gjykata ka marrë në konsideratë se rreziku penal dhe vlera e dëmshme e veprës penale ka qenë relativisht e vogël dhe vepra penale nuk ka rezultuar me dëme të konsiderueshme të vlerës së mbrojtur.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 4, të KPPK, pasi që pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurës dhe personave që ajo detyrohet t'i mbështes materialisht, e po ashtu edhe për faktin se e njëjta është shfrytëzues i ndihmës sociale, sipas kartelës nr.numri i kartelës..., të lëshuar nga QPS-Prishtinë, me datë 28.09.2015.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 27.04.2017.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.975/14, datë 26.04.2017.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.